



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.541/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetari i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit R.... shpk me seli në Fushë Kosovë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh.A. SCLR Partners kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në Prishtinë, me bazë juridike, vlerësim tatimor, duke vendosur sipas ankesës të ushtruar nga e paditura, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.1455/2017 të datës 21.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.10.2022, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, e ushtruar me datë 08.07.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.1455/2017 i datës 21.04.2021, Vërtetohet.

### A R S Y E T I M

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, në pikën I të dispozitivit ka vendosur Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R....shpk me seli në Fushë Kosovë, në pikën II. Anulohet Pjesërisht vendimi i paditurit Administrata Tatimore të Kosovës nr.241/2017 dt.27.07.2017 dhe atë në pjesën që lidhet me mos pranimin e transaksioneve të kredi dhe debi notave për periudhën tatimore CD/2016 për TAK, dhe në pikën III.Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditësit R....shpk nga Fushë Kosova, ta liroj nga tatimi shtesë prej 11,363.36€ për periudhën tatimore CD/2016 llojin e tatimit TAK-Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, si rrjedhojë e mos pranimit të transaksioneve të kredi dhe debi notave, si dhe ta liroj nga ndëshkimi prej 25% i përllogaritur mbi këtë bazë në shumën prej 2,840.84€, që në total përllogarithen në shumën prej 14,204.20€, në pikën IV. Vlersimet tjera mbesin në fuqi sips Njoftim Rivlerësimeve të tatimit shtesë të caktuara me Raportin e Kontrollit nr.01/17 dt.17.05.2017

Kundër këtij Aktgjykimi, në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura ATK, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e të paditurës ATK, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1455/17 dt.21.04.2021, dhe të mbetet në fuqi vendimi kontestues i ATK-së apo

qështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje. ATK-ja konsideron se gjykata gabimisht ka interpretuar normat ligjore dhe nuk ka dhënë arsytim lidhur me faktin se bazuar në nenin 37 par.2.1 të Ligjit 05/L-037 për TVSH, janë të përcaktuara kriteret që merren për bazë gjatë vlersimit të obligimeve tatimore lidhur me eksportet përkatësisht obligimin për të mbajtur një faturë ose dokument që shërben si faturë dhe po ashtu neni 36 par.2.2 nënp.2.2 kërkohet DUD-i me të cilin dëshmohet si pranues i dërgesës ose importues. Padiësi nuk ka ofruar dëshmi për të vërtetuar se kjo notë kreditore ka ndodhur dhe se tatimpaguesit duhet të lidhin kontratë paraprakisht ku specifikohen të gjitha kriteret e shitblerjes mes palëve. Ekspertiza financiare nuk është e bazuar, e paqartë dhe e pakuptueshme.

I autorizuari i padiësit në përgjigjen në ankes deklaroi se është i gabuar konstatimi se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë me shkelje të dispoziatve materiale dhe me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. I propozojm gjykatës që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e paditurit dhe ta vërtetoj aktgjykimin e shkallës së parë 1455/17 dt.17.05.2017.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe prentimet ankimore, si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me vendimin nr.241/2017 datës 27.07.2017, ka refuzuar si të pa bazë ankesën e padiësit R.... shpk nga Fushë Kosova me nr. Regjistrimit biznesit .... dhe ka vërtetuar si të bazuara Njoftim Rivlerësimet e tatimit shtesë të caktuara me kontroll. Padiësi me padi ka inicuar konfliktin administrativ në gjykatë me të cilën ka propozuar gjykatës të aprovohet në tërsi si e bazuar kërkespadija e padiësit të anulohet në tërsi si i pabazuar vendim i ATK-së nr.241/2017 dt.27.07.2017 dhe Raporti i Kontrollit 01/2017 dt.17.05.2017, ashtu që padiësi të lirohet nga të gjitha tatimet shtesë ndëshkimet dhe interesat e shqiptuara me raport kontrolli.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 08.04.2021, në prani të autorizuarit të palës padiëse e në mungesë të palës së paditur e cila ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt me datën 23.02.2021, dhe ekspertit financiar gjyqësor, pas administrimit të provave, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon Kërkesëpadijën e padiësit, e anulon pjesërisht vendimin e të paditurit Administrata Tatimore të Kosovës nr.241/2017 dt.27.07.2017 dhe atë në pjesën që lidhet me mos pranimin e transaksioneve të kredi dhe debi notave për periudhën tatimore CD/2016 për TAK, dhe Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që padiësit R....shpk nga Fushë Kosova, ta liroj nga tatimi shtesë prej 11,363.36€ për periudhën tatimore CD/2016 llojin e tatimit TAK-Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, si rrjedhojë e mos pranimit të transaksioneve të kredi dhe debi notave, si dhe ta liroj nga ndëshkimi prej 25% i përlogaritur mbi këtë bazë në shumën prej 2,840.84€, që në total përlogariten në shumën prej 14,204.20€, Vlersimet tjera mbesin në fuqi sipas Njoftim Rivlerësimeve të tatimit shtesë të caktuara me Raportin e Kontrollit nr.01/17 dt.17.05.2017.

Në arsyetim të Aktgjykimit të atakuar me ankesë, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se e paditura nuk e ka trajtuar dokumentacionin përcjellës që i janë bashkangjitur kontrata

mes dy palëve kontraktuese dt.12.01.2016, anekset me të cilat janë parapa qmimet e shitblerjes sipas llojit të mallit si dhe klasifikimi i mallit, pastaj kredi notat e lëshuara nga blerësi nga Shkupi ....., subjektit R...., të shoqëruara me shkresat përkatëse, transaksionet bankare, faturat dhe DUD-at bashk me CMR-at për të gjitha eksportet e realizuara në periudhen e përfshirë me kontroll. Me këtë rast gjykata i fali besimin ekspertizës financiare me të cilën është vërtetuar gjendja faktike e dokumentacionit bashkangjitur lëndës si dhe dispozitave ligjore në fuqi, me ç'rast është vlerësuar konstatimi se e paditura nuk ka marrë parasysh korigjimet e vlerës së mallit të eksportuar me korigjim të vlerës së eksporteve të realizuara sipas faturave eksportuese.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, aprovon vlersimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK-së. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, ekspertizës financiare si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e anuluar pjesërisht vendimin nr.241/2017 i datës 27.07.2017 të paditues Administrat Tatimore e Kosovës, dhe e obligon të paditurën që paditësit t'ia t'ia kthej mjetet financiare të inkasuara si rrjedhojë e mos pranimit të transaksioneve të kredi dhe debi notave, dhe në emër të ndëshkimit prej 25%, i përlllogarit mbi këtë bazë, ndërsa pjesën tjetër të vlersimit sipas Njoftim Rivlerësimit të tatimit shtesë me Raportin e Kontrollit nr.01/17 dt.17.05.2017, e ka lënë në fuqi.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht dispozitat ligjore nenit 2,31,36,41 dhe 47 të Ligjit nr.05/L-37 për TVSH, me të cilat përcaktohen rastet e trajtimit të kredi dhe debi notave për qëllim të korigjimit të vlerës së faturave dhe rrgullimeve përkatëse në librat e kontabilitetit dhe në Deklaratat tatimore. Në këtë rast gjendja faktike është vërtetuar drejt nga gjykata e shkallës së parë e cila përmes ekspertizës financiare dt.12.02.2021 ka vërtetuar faktet se paditësi ka eksportuar mall-mbeturina në Republikën e Maqedonisë, në vlerë prej 8,765,192.17€, të cilën shumë e ka deklaruar në ATK-ë dhe të cilën gjendje e ka konfirmuar edhe inpektori tatimor si në fqen 17 dhe 18 të Raportit të Kontrollit, ndërsa në të njëjtën deklaram tatimor janë pasqyruar edhe shumat e kredit notave dhe debit notave nga edhe ka rezultuar diferenca financiare. Në anën tjetër pala e paditur gjatë kontrollit dhe as në gjykatë gjatë zhvillimit të konfliktit administrativ, nuk ka provuar të dëshmoj pse nuk është bërë verifikimi i gjithë dokumentacionit për të vërtetuar drejt diferencën e transaksioneve nga debi kredit e notave, por vetëm ka nxjerr gjendjen faktike në mënyrë të kufizuar nga importet e Dekaratave Unike Doganore të referuar ne nenin 37 par.2.1 të Ligjit nr.05.L-037 për TVSH, e nga të cilat diferenca ka rezultuar tatimi shtesë i përcaktuar me Raport Kontrollin.

Andaj Kolegji, gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet në ankes, sepse gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, në kuptim të nenit 38 dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative si në vështrim të nenit 43.1 të LKA-së si dhe shkresave të tjera, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, dhe në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar vet gjendjen faktike, dhe ka vendosur meritorisht për çështjen juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore tatimore, ku pa dyshim vërtetohet se, në bazë dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës, ekspertizës financiare të datës 02.04.2021, dhe deklarimit të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor, eksperti ka dhënë vlersimin profesional para gjykatës se dokumentacionet në lëndë krijojnë bazën për pranimin e transaksioneve të kredit dhe debit notave, të korigjuara në vlerën e mallit të eksportuara

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, sepse nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të vërtetonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë. Andaj, sipas vlerësimit të Kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës.

Gjykata i vlersoi edhe pretendimet tjera të pales së paditur, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkaallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar ligjin material.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji I Dhomës ë Shkallës ë Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe të LKA-së, dhe nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të paditurës. Pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.541/22 datë 06.10.2022

Kryetari i Kolegjit – gjyqtari  
Krenar Berisha